



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

DOKUMENT I SHKURTËR I POLITIKAVE

FORCA E SIGURISË E KOSOVËS ËSHTË USHTRI

Argumentet juridike

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Robert Muharremi ©

Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit 2011/04-L-065. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë dhe përmes asnjë mjeti elektronik, mekanik apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi.

Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe partnerëve.

Përmbajtja

I. Hyrje.....	4
II. Rregullimi aktual juridik-kushtetues i Forcës së Sigurisë të Kosovës	4
III. A e ndalon Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndryshimin e legjisllacionit për FSK, përmes të cilit do të eliminoheshin kufizimet sa i përket armatimit dhe kompetencave të FSK	5
IV. A e ndalon “Pakoja e Ahtisarit” shndërrimin e FSK në ushtri?	6
V. A e ndalon Deklarata për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës trajtimin e FSK si ushtri?	7
VI. A e ndalon Rezoluta 1244 (1999) trajtimin e FSK si ushtri?	8
VII. Përfundim	10

I. Hyrje

Kufizimet ligjore të vendosura lidhur me armatimin, numrin e pjesëtarëve si dhe me kompetencat e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) e bëjnë që ajo në publik të mos konsiderohet si ushtri. Në debatin publik është diskutuar mundësia e ndryshimit të Kushtetutës për të shndërruar FSK në ushtri. Në këtë mendim juridik do të argumentohet që sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, FSK veç është forcë ushtarake dhe nuk ka nevojë që të ndryshohet Kushtetuta për të eliminuar kufizimet aktuale që e pengojnë atë të jetë forcë e plotë ushtarake. Të gjitha kufizimet aktuale mund të eliminohen përmes ndryshimit të legjislacionit përkatës brenda dispozitave ekzistuese të Kushtetutës.

Ndryshimi i Kushtetutës do të kërkonte miratimin e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës (neni 144.2 i Kushtetutës). Në anën tjetër, pasi që legjislacioni për FSK nuk paraqet legjislacion me interes vital (neni 81 i Kushtetutës), ndryshimi i legjislacionit për FSK do të mund të miratohej nga Kuvendi i Kosovës vetëm me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë (neni 80.1 i Kushtetutës).

II. Rregullimi aktual juridik-kushtetues i Forcës së Sigurisë të Kosovës

Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë të Kosovës, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-108 dhe Ligjin nr. 04/L-115.

FSK është institucion i sigurisë i cili sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës është në funksion të mbrojtjes së rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, dhe e cila funksionon nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës (neni 4, para. 7). FSK është e përcaktuar si forcë kombëtare e sigurisë për Repub-

likën e Kosovës (neni 126, para. 1) e cila mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj (neni 126, para. 2). Ajo është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës (neni 126, para. 4). Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i FSK (neni 126, para. 3), ndërsa Komandantin e FSK e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të Qeverisë (neni 126, para. 5).

Sipas Ligjit nr. 03/L-046, i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, FSK është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë (neni 9, para. 1). FSK është e strukturuar dhe e përgatitur për të përmbyshur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë ose organizatave tjera për zbatim të ligjit (neni 9, para. 3).

Sipas ligjit ë fjalë, FSK është e armatosur lehtë dhe nuk ka armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë ose kapacitete sulmuese ajrore (neni 10, para. 2). Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve, parashikohet të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Detyrat fillestare të FSK sipas ligjit janë:

- i. të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes. Kjo do të përfshijë operacionet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim;
- ii. të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare;
- iii. të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes;
- iv. të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.

Po ashtu, sipas ligjit, FSK fillimisht përbëhet nga një komponentë aktive prej më së shumti 2500 pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej më së shumti 800 pjesëtarë (neni 14).

Kufizimet ligjore të vendosura lidhur me armatimin, numrin e pjesëtarëve si dhe me kompetencat e FSK, të cilat nuk janë të natyrës ushtarake por kryesisht të reagimit emergjent ndaj krizave dhe fatkeqësive natyrore, e bëjnë që FSK të mos konsiderohet si ushtri.

Në këtë pikë duhet theksuar se emërtimi nuk e përcakton nëse një institucion është ushtri apo diçka më pak se ushtri. Termi “ushtri” mund të përkufizohet si tërësia e forcave të armatosura të një vendi¹ në kuptimin e një trupi të organizuar të personelit ushtarak, i cili është profesionalisht i aftësuar dhe i pajisur për luftë². Një shtet mund të ketë një ushtri edhe pa e emërtuar këtë trup si ushtri, sepse substanca e atij trupi, d.m.th. funksioni, kompetencat, armatimi dhe organizimi e përcaktojnë nëse është ushtri apo jo. Ushtria e Gjermanisë quhet zyrtarisht “*Bundeswehr*”, që nëse përkthehet tekstualisht në gjuhën shqipe do të thotë “mbrojtja e federatës”. Ushtria e Izraelit quhet “*Israeli Defence Forces*”, në shqip “forcat mbrojtëse të Izraelit”. Ngjashëm, ushtria e Australisë quhet “*Australian Defence Force*”, në shqip “forca mbrojtëse e Australisë”. Pa marrë parasysh emërtimet e tyre, këto janë ushtri për shkak të kompetencave, armatimit dhe organizimit që kanë dhe për shkak të funksionit ushtarak që e kryejnë.

Në këtë kuptim, Republika e Kosovës mund të ketë ushtrinë e vet edhe nëse nuk e emërton zyrtarisht me termin “ushtri”, por nëse i jep funksionet, kompetencat, armatimin dhe organizimin që është tipik për një forcë ushtarake. FSK do të mund të konsiderohej ushtri në kuptimin e plotë të fjalës nëse do të eliminohej kufizimet ligjore të cekura si më lartë sa i përket armatimit, funksionit dhe kompetencave të saj dhe nëse do të përcaktohej ligjërisht si institucion i sigurisë i natyrës ushtarake i Republikës së Kosovës. Me këtë ngritje pyetje se a mund të eliminohej këto kufizime pa e ndryshuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë FSK të konsiderohet forcë ushtarake.

III. A e ndalon Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndryshimin e legjislacionit për FSK, përmes të cilit do të eliminohej kufizimet sa i përket armatimit dhe kompetencave të FSK

Kushtetuta nuk i përmban kufizimet në lidhje me kompetencat dhe armatimin e FSK, siç janë të përcaktuara me ligj. Ajo e përkufizon FSK si forcë kombëtare të sigurisë e cila mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj (neni 126, para. 1 dhe 2). Gjuha dhe shprehjet të cilat i përdor Kushtetuta japin hapësirë të mjaftueshme interpretimi për të nxjerrë përfundimin se Kushtetuta nuk e ndalon trajtimin e FSK si ushtri dhe nuk e ndalon eliminimin e kufizimeve aktuale vetëm përmes ndryshimit të legjislacionit.

Funksioni kryesor kushtetues i FSK është mbrojtja e qytetarëve dhe të komuniteteve të Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh që, sipas Kushtetutës, Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet (neni 1, para. 2) dhe sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli dhe i takon popullit (neni 2, para. 1), mbrojtja e qytetarëve dhe të komuniteteve të Republikës së Kosovës nënkupton edhe mbrojtjen e sovranitetit të Republikës së Kosovës dhe me këtë edhe të gjitha atributëve të tjera që e bëjnë Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Folja “mbrojtje”, siç përdoret në Kushtetutë për të cilësuar funksionin e FSK, do të thotë të ruaj dikë apo diçka nga ndonjë sulm a ndonjë rrezik tjetër.³ Në kuptimin ushtarak, folja “mbrojtje” nënkupton organizimin e mbrojtjes dhe luftën me armë kundër armikut për të ruajtur një vend.⁴ Fakti që Kushtetuta e cilëson FSK si forcë nënkupton që ajo duhet të ketë në dispozicion të gjitha mjetet fizike, përfshirë armatimin e nevojshëm, për të realizuar me sukses funksionin e saj, gjë që është mbrojtja e qytet-

1 Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Shqipes së Sotme, Tiranë: 2002, fq. 1413.

2 Oxford Dictionaries: Definition: “Army”, në: (<http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/army>, qasja e fundit me datën 16.08.2015).

3 Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Shqipes së Sotme, Tiranë: 2002, fq. 754.

4 Ibid.

arëve dhe komuniteteve të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Kushtetuta shprehimisht përdor termin “rekrutim” (neni 126, para. 4), shprehje kjo e cila përdoret në mënyrë tipike për forca ushtarake. Ngjashëm me këtë, FSK ka “komandant”, po ashtu një shprehje tipike për një forcë ushtarake. Në bazë të këtij interpretimi tekstual të Kushtetutës mund të konkludohet që ka bazë të mjaftueshme kushtetuese për të konsideruar FSK si forcë të natyrës ushtarake.

Ky interpretim mbështetet edhe nga konteksti normativ brenda të cilit Kushtetuta e ka rregulluar FSK-në. FSK bën pjesë në institucionet e sigurisë dhe renditet e para ndër të gjitha institucionet e tjera. Institucionet e tjera të sigurisë përfshijnë komponentët jo-ushtarak, siç janë Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli i Sigurimit dhe Autoriteti Civil i Aviacionit. Krahasuar me këto institucione, dhe duke parë gjuhën të cilën e përdor Kushtetuta, FSK del si institucion i sigurisë i karakterit ushtarak siç e ka çdo shtet tjetër.

Kushtetuta nuk i përcakton funksionet dhe kompetencat e FSK përtej asaj të “mbrojtjes së qytetarëve dhe të komuniteteve”, por ia delegon ligjvënësit që përmes ligjit të përcaktojë këto (neni 126, para 2). Kufizimet sa i përket kompetencave dhe armatimit nuk janë të përcaktuara me Kushtetutë por me ligj. Ky ligj mund të ndryshohet dhe të eliminohen kufizimet ekzistuese ligjore me qëllim që FSK në mënyrë efektive të realizojë funksionin e saj kushtetues të mbrojtjes së qytetarëve dhe komuniteteve. Në fakt, në bazë të Kushtetutës FSK veç është ushtri, por për shkak të kufizimeve ligjore është bërë duket dhe të perceptohet si diçka më pak se ushtri, gjë që nuk ka bazë kushtetuese.

IV. A e ndalon “Pakoja e Ahtisarit” shndërrimin e FSK në ushtri?

Pyetja që mund të shtrohet është se a e ndalon Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës i datës 26.03.2007 (Pako e Ahtisarit) trajtimin e FSK si ushtri. Themelimi i FSK ishte paraparë me Pakon

e Ahtisarit (Shtojca VIII, neni 5.1)⁵. Kufizimet aktuale ligjore sa i përket armatimit, numrit të pjesëtarëve të saj dhe kompetencave kanë qenë të përcaktuara në këtë dokument. Shtojca VIII, neni 5.2, ka përcaktuar që FSK do të jetë e armatosur lehtë dhe nuk do të posedojë armë të rënda si, tanke, artileri të rëndë apo kapacitet ajror ofanziv. FSK do të përbëhet prej jo më tepër se 2500 pjesëtarëve aktiv dhe 800 pjesëtarëve rezervë. Sipas Shtojcës VIII, neni 5.4, fillimisht, FSK do të jetë kryesisht përgjegjëse për përgjigjen ndaj krizave, asgjësimin e mjeteve eksplozive dhe mbrojtjen civile. Gjithashtu, FSK do të dizajnohet dhe përgatitet për përmbushjen e funksioneve tjera të sigurisë, të cilat nuk janë të përshtatshme për policinë apo organizatat tjera të zbatimit të ligjit.

Pasi që Pakoja e Ahtisarit nuk u votua nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Kosova pas shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka inkorporuar Pakon e Ahtisarit si pjesë të Kushtetutës. Neni 143 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka përcaktuar si vijon:

1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës vepronë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Me këtë dispozitë, Kushtetuta i ka dhënë epërsi të

⁵ Neni 5.1: Në Kosovë do të themelohet një Forcë e re e Sigurisë (FSK), e cila do të jetë profesionale dhe shumetnike.

plotës Pakos së Ahtisarit ndaj vet Kushtetutës dhe të gjitha akteve tjera normative të Republikës së Kosovës. Edhe pse kufizimet sa i përket armatimit, numrit të pjesëtarëve dhe kompetencave të FSK nuk kanë qenë të përfshira në nenin 126 të Kushtetutës, dispozitat e Pakos së Ahtisarit kanë qenë drejtpërdrejtë të zbatueshme dhe me efekt juridik mbi vet Kushtetutën. Për këtë arsye, për aq kohë sa ka qenë në fuqi Pakoja e Ahtisarit, FSK i ka pasur kufizimet e cekura si më sipër edhe në nivelin kushtetues dhe nuk ka qenë e mundur që përmes ndryshimit të ligjit të eliminohen këto.

Kjo gjendje juridike ka ndryshuar me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të Kosovës me datën 10.09.2012 të cilës i kanë paraprirë ndryshimet kushtetuese të datës 07.10.2012. Me këto ndryshime kushtetuese janë shlyer nga Kushtetua të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me Pakon e Ahtisarit, si dhe zbatimin dhe epërsinë juridike të këtij dokumenti. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve, Pakoja e Ahtisari nuk ka më fuqi normative dhe nuk është më e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Me këtë, edhe të gjitha dispozitat që kanë pasur të bëjnë me kufizimet sa i përket FSK janë bërë të pavlefshme. Që nga data 07.10.2012 baza kushtetuese e FSK është vetëm neni 126 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës pa asnjë prej kufizimeve që më parë kanë qenë të përcaktuara në Pakon e Ahtisarit. Që nga kjo datë, kufizimet aktuale sa i përket armatimit, pjesëtarëve dhe kompetencave të FSK nuk janë më të rangut kushtetues, por vetëm të rangut ligjor. Për këtë arsye, Pakoja e Ahtisarit nuk e ndalon më trajtimin e FSK si ushtri si dhe nuk e ndalon ndryshimin e legjislacionit për të eliminuar kufizimet aktuale.

V. A e ndalon Deklarata për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës trajtimin e FSK si ushtri?

Në deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës të datës 17.02.2008 përfaqësuesit e popullit të Kosovës janë deklaruar, ndër të tjera, si vijon:

Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim

Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërish e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit.

Përfaqësuesit e popullit të Kosovës janë zotuar se do të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Pakoja e Ahtisarit, përfshirë ato që kanë të bëjnë me kufizimet sa i përket FSK-së. Ky zotim është bërë si deklaratë e njëanshme me fuqi juridike në rrafshin e të drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, ky zotim duhet të interpretohet në kontekstin e tij historik dhe sipas qëllimit që e ka pasur në atë kontekst. Kosova e ka bërë këtë zotim për t'i dëshmuar bashkësisë ndërkombëtare që është e gatshme të zbatojë të gjitha rekomandimet e përfshira në Pakon e Ahtisarit dhe të pranojë për këtë qëllim një mbikëqyrje ndërkombëtare. Ky zotim është realizuar kur me datën 10.09.2012 vet përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare të përfshirë në mbikëqyrjen e Kosovës janë deklaruar se Republika e Kosovës i ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Pakoja e Ahtisarit dhe se Pakoja e Ahtisarit nuk gjen më zbatim. Këtë deklaratë nuk e ka bërë Kosova, por e kanë bërë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Plotësimi detyrimeve që rrjedhin nga Pakoja e Ahtisarit, dhe deklarimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare si të përmbyllur, paraqet një rast tipik të "rebus sic stantibus", doktrinë kjo e njohur dhe zbatuar në të drejtën ndërkombëtare. Sipas kësaj doktrine, një shtet lirohet nga një detyrim nëse baza faktike mbi të cilën është

krijuar ky detyrim ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore.⁶ Baza faktike për zotimin e Kosovës për t'iu përmbajtur Pakos së Ahtisarit ka qenë fakti që në kohën kur Kosova e ka bërë këtë zotim kjo Pako ende nuk ka qenë e zbatuar dhe kërkohej një zotim serioz nga Kosova për këtë. Kjo ka ndryshuar në çastin kur vet bashkësia ndërkombëtare ka deklaruar në vitin 2012 se detyrimet nga Pakoja e Ahtisarit janë plotësuar dhe me këtë është eliminuar baza faktike për zotimin e Kosovës në vitin 2008. Për këtë arsye, konform doktrinës *"rebus sic stantibus"*, Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë nuk paraqet pengesë juridike për trajtimin e FSK si ushtri.

VI. A e ndalon Rezoluta 1244 (1999) trajtimin e FSK si ushtri?

Rezoluta 1244 (1999) ka autorizuar krijimin e një pranie ndërkombëtare ushtarake në Kosovë me këto funksione:

- Pengimin e ripërtëritjes së armiqësive, ruajtjen dhe atje ku është e nevojshme imponimin e armëpushimit, si dhe sigurimin e tërheqjes dhe parandalimit të kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Federatës dhe të Republikës, përveç siç është paraparë në pikën 6 të aneksit 2;
- Demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës siç kërkohet në paragrafin 15 më poshtë;
- Krijimin e një ambienti të sigurisë në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen të sigurt në shtëpitë e tyre, ku mund të funksionojë prania civile ndërkombëtare, ku mund të krijohet një administratë kalimtare, dhe ku mund të shpërndahen ndihmat humanitare;
- Garantimin e sigurisë dhe të rendit publik derisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;

- Mbikëqyrjen e procesit të deminimit derisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;
- Përkrahjen, si të shihet e përshtatshme, dhe bashkëpunimin e ngushtë me punën e pranisë civile ndërkombëtare;
- Kryerjen e detyrave vëzhguese në kufi siç kërkohet, dhe
- Sigurimin e mbrojtjes dhe të lirisë së lëvizjes për vete, pranimë civile ndërkombëtare dhe për organizatat e tjera ndërkombëtare.

Prania ndërkombëtare ushtarake sipas rezolutës 1244 është KFOR e udhëhequr nga NATO. Duke e marrë parasysh faktin që rezoluta 1244 e ka autorizuar një prani ndërkombëtare ushtarake në Kosovë, mund të shtrohet pyetja se a e ndalon rezoluta 1244 trajtimin e FSK si ushtri të Republikës së Kosovës.

Në rend të parë duhet theksuar se Republika e Kosovës, si shtet i cili nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara, nuk është e detyruar të respektojë një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) ka konfirmuar se shtetet jo-anëtare nuk kanë për detyrë të zbatojnë nenin 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila kërkon nga shtetet anëtare të zbatojnë rezolutat e Këshillit të Sigurimit.⁷ Kjo vlen edhe për Republikën e Kosovës deri sa nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Kjo do të thotë se rezoluta 1244 nuk është e zbatueshme drejtpërdrejtë në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës, përveç nëse me aktet normative të Republikës së Kosovës kësaj rezolute i jepet ndonjë fuqi juridike.

Në Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës përfaqësuesit e popullit të Kosovës janë deklaruar që

"Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përm-

⁶ J. Crawford, "Brownlie's Principles of Public International Law", Oxford: 2012, fq. 393.

⁷ International Court of Justice, Advisory Opinion of 21 June 1971 on the Legal Consequences for States of the Continued Presence of South Africa in Namibia Notwithstanding Security Council Resolution 276 (1970), para. 126.

bajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Planit i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999)."

Në lexim të parë, kjo mund të interpretohet si zotim i Kosovës për të zbatuar rezolutën 1244 (1999) në tërësi dhe me veprim të drejtpërdrejtë të saj. Mirëpo, kjo pjesë e deklaratës së shpalljes së pavarësisë duhet të lexohet së bashku me pjesën vijuese të deklaratës sipas të cilës:

"Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Europian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë."

Sipas kësaj, prani të ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë edhe praninë ndërkombëtare ushtarake të themeluar sipas rezolutës 1244 (1999), ushtrojnë detyrat e tyre të përcaktuara me këtë rezolutë jo në bazë të fuqisë juridike të kësaj rezolute, por në bazë të ftesës dhe pëlqimit të Republikës së Kosovës si shtet sovran. Çdo kompetencë që e ushtrojnë prani të ndërkombëtare në Kosovë, edhe nëse ato janë të përcaktuara në rezolutën 1244 (1999), kanë për bazë juridike pëlqimin e Kosovës e jo rezolutën 1244 (1999). Përveç kësaj, ftesa dhe pëlqimi i Kosovës janë dhënë me kushtin *"deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi"*. Inter-

pretuesi përfundimtar se kur ky kusht mund të konsiderohet i plotësuar është vet Republika e Kosovës, sepse deklarata është e Kosovës. Megjithatë, fakti që bashkësia ndërkombëtare, e përfaqësuar nga shtetet që kanë qenë të përfshirë në mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës, ka ardhur në përfundim që Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet e Pakos së Ahtisarit, nënkupton që vet bashkësia ndërkombëtare ka konstatuar që Kosova është në gjendje të marr përsipër përgjegjësitë shtesë, përfshirë ato në fushën e sigurisë.

Në këtë kontekst duhet të merret parasysh edhe mendimi këshillëdhënës i GJND i datës 22.07.2010, ku ajo ka vërtetuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkel te drejtën ndërkombëtare, përfshirë këtu rezolutën 1244. Argumenti mbi të cilin GJND e ka bazuar këtë përfundim është se deputetet që e kanë shpallur pavarësinë e Kosovës nuk kanë vepruar në kuadër të rezolutës 1244, por kanë vepruar si përfaqësues të popullit të Kosovës jashtë kornizës së administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara. Në këtë cilësi, deputetet e Kuvendit të Kosovës nuk kanë qenë adresat i rezolutës 1244 dhe për këtë arsye kjo rezolute nuk ka krijuar pengesë juridike për shpalljen e pavarësisë. Mundësia e vetme për të argumentuar që shpallja e pavarësisë nuk e ka shkelur rezolutën 1244 dhe me këtë të drejtën ndërkombëtare ka qenë argumenti që shpallja e pavarësisë është bërë jashtë rezolutës 1244. Po të kishte gjykuar GJND që deputetet kanë vepruar në kuadër të rezolutës 1244, GJND detyrimisht do të kishte ardhur në përfundim që shpallja e pavarësisë ka qenë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Me këtë, GJND ka konfirmuar që tërë procesi i shpalljes së pavarësisë është jashtë rezolutës 1244 dhe nuk ka asnjë lidhje me të dhe i tërë rendi kushtetues dhe juridik i Kosovës është i vendosur jashtë rezolutës 1244 (1999).

Përveç kësaj, vet teksti i rezolutës 1244 (1999), siç është cekur më lartë, nuk e pengon trajtimin e FSK si ushtri. Rezoluta parasheh sigurimin e tërheqjes dhe parandalimin e kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Federatës dhe të Republikës, por kjo nuk nënkupton që Kosova të mos ketë ndonjë forcë ushtarake të vetën të themeluar dhe të organizuar në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare

ushtarake, siç është FSK. Po ashtu, demilitarizimi i UÇK nuk është pengesë juridike, sepse FSK është forcë e themeluar në vitin 2008 e cila në pikëpamje juridike nuk ka lidhje institucionale me UÇK-në. Detyrat tjera të pranisë ndërkombëtare ushtarake sipas rezolutës 1244 (1999) ose janë përmbyllur (p.sh. krijimin e një ambienti të sigurisë në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen; garantimin e sigurisë dhe të rendit publik derisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë) ose mund të kryhen paralelisht me një forcë ushtarake të Kosovës. Në të gjitha pikëpamjet, rezoluta 1244 (1999) nuk paraqet pengesë juridike për trajtimin e FSK si ushtri sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Edhe në rrafshin kushtetues, çdo referencë në praninë ndërkombëtare ushtarake sipas rezolutës 1244 (1999) është eliminuar. Neni 153 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 2008 ka përcaktuar si vijon:

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, të pakësojë ose përndryshe të kufizoj mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen.

Me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë në vitin 2012, edhe kjo dispozitë e Kushtetutës është shlyer (Amendamenti 14 i Kushtetutës së vitit 2012) dhe me këtë është hequr çdo detyrim kushtetues sa i përket pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe kompetencave të saj sipas rezolutës 1244 (1999).

VII. Përfundim

Nga argumentet si më sipër rezulton që nuk ka asnjë pengesë juridike-kushtetuese që FSK të trajtohet si ushtri dhe që përmes ndryshimeve në legjisllacionin përkatës, dhe pa e ndryshuar Kushtetutën, të eliminohen kufizimet aktuale në lidhje me funksionet, kompetencat, armatimin dhe numrin e pjesëtarëve të saj.

Ndryshimet e nevojshme mund të bëhen përmes ndryshimit të Ligjit nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë të Kosovës, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-108 dhe Ligjin nr. 04/L-115 duke shlyer dispozitat që përmblajnë kufizimet sa i përket kompetencave, armatimit dhe personelit të FSK dhe duke e qartësuar rolin e FSK si forcë ushtarake në pajtim me nenin 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

355:34(496.51)

Muharremi, Robert

Dokument i shkurtër i politikave : forca e sigurisë e Kosovës është ushtri- argumentet juridike / Robert Muharremi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2016. – 12 f. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-679-38-1

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-38-1



9 789951 679381